



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të nenit 4.5 , 64.2 pika (a) dhe (b), , nenit 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Ligjit Nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nenit 4.4, nenit 11.2, 29.2, si dhe nenit 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 02.07. 2013 nxjerr:

## **RREGULLËN ZGJEDHORE Nr. 15/2013 ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME DHE ZGJEDHJET E PARAKOHSHME**

### **Neni 1**

#### **Dispozitat e përgjithshme**

- 1.1 Kjo rregull zgjedhore ka për qëllim të rregullojë: kompetencën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në caktimin e afateve kohore për implementimin e aktiviteteve zgjedhore, pas publikimit të datës së zgjedhjeve të jashtëzakonshme apo zgjedhjeve parakohshme.
- 1.2 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme qeverisen përmes ligjeve të njëjta dhe rregullave zgjedhore të KQZ-së sikurse edhe zgjedhjet tjera, përveç se KQZ-ja mund të ndryshojë afatet kohore në rast se kjo nevojitet për shkak të rrethanave.
- 1.3 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme të Përgjithshme dhe Lokale (më tej: Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme) shpallen nga Presidenti i Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 4.4 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale, përkatësisht nenin 4.5 të Ligjit 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
- 1.4 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe të Parakohshme nuk mund të mbahen më herët se tridhjetë (30) ditë dhe më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas shpërbërjes së Kuvendit të Kosovës ose Kuvendit Komunal, përkatësisht apo pas shkaktimit të rrethanave që kanë

ndikuar në mbajtjen Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunave.

- 1.5 Me afatet kohore të përcaktuara me këtë rregull zgjedhore nënkuptohen Ditët Kalendarike.

## **Neni 2**

### **Përkufizimet**

- 2.1 **KQZ** - do të thotë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organ i pavarur i ekspertëve përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve;
- 2.2 **Zgjedhje** - do të thotë zgjedhje për Kuvendin e Kosovës, apo për Kuvendin Lokal;
- 2.3 **Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ)** - është organ përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve zgjedhore brenda territorit të komunës;
- 2.4 **Subjekti politik** - do të thotë parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur;
- 2.5 **Subjekti(et) i certifikuar politik** - do të thotë subjekti politik, që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e KQZ-së;
- 2.6 **Votuesi jashtë Kosovës** - do të thotë aplikuesi i suksesshëm nga jashtë Kosovës që përdor një nga mënyrat e votimit jashtë territorit të Kosovës, siç është e saktësuar në rregullat e KQZ-së;
- 2.7 **Qendra e Votimit (QV)** - do të thotë ndërtesa ku ndodhen një apo më shumë vendvotime për qëllim të votimit në zgjedhje dhe përfshinë një hapësirë publike brenda rrezes 25 metra nga dera e hyrjes në ndërtesë;
- 2.8 **Vendvotimi (VV)** - do të thotë një dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm për qëllim të votimit në Ditën e Zgjedhjeve dhe që, po ashtu, përfshinë hapësirën publike me rreze prej 25 metra të hyrjes në ndërtesë në të cilën ndodhet vendvotimi;
- 2.9 **Shpenzimi për fushatë** - do të thotë çdo pagesë e bërë për mallra ose blerje të mallrave, materialeve, punës, shërbimeve, qofshin ato të prekshme ose të paprekshme,

me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në zgjedhje, pavarësisht nëse bëhen për mbështetje të kandidatit të posaçëm, partisë politike, koalicionit ose nismës qytetare, siç janë shpenzimet për reklamim në mediat e shtypura; prodhimin e spoteve transmetuese; materialet e fushatës, përfshirë pamfletet, posterët, butonat; ekspozim të reklamave, përfshirë standat e afishimit dhe prodhimin e tyre; kontributet bamirëse. Këto nuk përfshijnë shpenzimet e bëra në mbështetje të veprimtarive të rregullta të subjektit politik. Mallrat ose shërbimet për të cilat pagesat janë bërë para ose pas periudhës së fushatës, për përdorim gjatë periudhës së fushatës, po ashtu konsiderohen si shpenzime për fushatë;

- 2.10 **Lista e Votuesve (LV)** - do të thotë lista e të gjithë votuesve me të drejtë vote për zgjedhje siç përcaktohet në nenin 7.1 të LZP.
- 2.11 **Vëzhguesi i akredituar** - do të thotë përfaqësuesi i një subjekti të certifikuar politik, organizate joqeveritare, qeveritare ose ndërqeveritare, organizate ndërkombëtare të specializuara dhe të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, vendi të huaj, ose media, që ka dorëzuar kërkesën për vëzhgim të zgjedhjeve dhe ka marrë miratimin nga KQZ-ja në pajtim me LZP dhe me rregullat e KQZ-së.

### **Neni 3**

#### **Vendosja e kushteve dhe afateve kohore**

- 3.1 Më së largu në ditën në vijim të shpalljes së datës së zgjedhjeve të parakohshme apo të jashtëzakonshme, KQZ-ja do të nxjerrë dhe publikojë, vendimin për të caktuar, sipas datës dhe nëse është e nevojshme sipas periudhës, afatet kohore për ngjarjet e mëposhtme të procedurës zgjedhore:
- 3.1.1 afatet për krijimin e Listës së Votuesve dhe i periudhës së kundërshtimit dhe konfirmimit (nenin 6.1, 7.8, 8.1 e LZP dhe neneve 3.8 dhe 4.1 të Rregullës së zgjedhjeve nr. 2/2013);
- 3.1.2 afatet për procedurën e certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve (nenin 15, 16, 25 dhe 26 të LZP)
- 3.1.3 afati i shortit të fletëvotimit, dhe afati i fundit për tërheqje nga shorti i fletëvotimit (nenin 24.1 dhe 28.1 i LZP dhe nenin 10.1 të Rregullës zgjedhore nr. 08/2013);
- 3.1.4 afati për zëvendësimin e kandidatëve (nenin 28.3 i LZP);

- 3.1.5 afatet për publikimin e listave të kandidatëve të certifikuar dhe me çfarëdo ndryshime (nenin 29.7 i LZP);
  - 3.1.6 afati i fundit për të përcaktuar kufizimin e shpenzimeve për fushatë (nenin 39.1 i LZP dhe Rregullës zgjedhore nr. 12/2013);
  - 3.1.7 kohëzgjatja e fushatës zgjedhore si dhe afatet për tubimet e fushatës zgjedhore (nenin 3 i LZP dhe neneve 4.2, 4.3, 4.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2013);
  - 3.1.8 afatet për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe vëzhguesve (nenin 54.3, 54.4, 54.5, 54.6 dhe 58 të LZP dhe neneve 3 dhe 4.1 i Rregullës zgjedhore nr .07/2013);
  - 3.1.9 afatet për emërimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ) dhe Këshillave të Vendotimeve (KVV) (nenin 67.4, 69.3, 76.2, 76.4, 77.2 e LZP);
  - 3.1.10 afati i fundit për publikimin e Qendrave të Vendvotimi (nenin 83.1 i LZP dhe nenit 3.1 të Rregullës zgjedhore nr. 09/2013);
  - 3.1.11 afatet për aplikim për regjistrim si votues jashtë Kosovës, si dhe afatet e procesit të konfirmimit (neni 96.1 i LZP dhe nenin 3.5 të Rregullës zgjedhore nr.03/2013);
  - 3.1.12 afatet për aplikim për regjistrim si votues me nevoja të veçanta( nenin 100 i LZP dhe neneve 3.1, 5.1, 6.1, 6.3 të Rregullës nr. zgjedhore nr. 04/2013).
- 3.2 Raportet e Publikimit Financiar të Fushatës do të mbulojë periudhën nga shpallja e zgjedhjeve të parakohshme apo jashtëzakonshme deri në ditën e zgjedhjeve (nenin 40.1 i LZP dhe nenit 4.1 të Rregullës zgjedhore 12/2013).
- 3.3 Kushtet dhe afatet kohore që nuk janë përmendur në nenet 3.1 dhe 3.2 të kësaj rregulle do të jenë të njëjta siç përcaktohen në LZP, LZL dhe Rregullave zgjedhore të KQZ-së.

#### **Neni 4**

##### **Përfundimet tjera**

- 4.1 Në secilin vendvotim do të shërbejë një (1) Këshill i Vendvotimit (KVV), i cili do të reflektojë përbërjen e KKZ-së, siç përcaktohet në nenin 4. të Rregullës Zgjedhore Nr. 09/ 2013 .
- 4.2 Në secilën qendër të votimit do të shërbejë një (1) ekip i tavolinës ndihmëse, siç përcaktohet në nenin 6 të Rregullës Zgjedhore nr. 09/2013).

**Neni 5**

**Dispozita kalimtare dhe përfundimtare**

Me hyrjen ne fuqi të kësaj rregulle, shfuqizohet Rregulla nr. 15/2010 Zgjedhjet e Jashtëzakonshme dhe Zgjedhjet e Parakohshme, e datës 18.10.2010.

**Neni 6**

**Hyrja në fuqi**

Kjo rregull zgjedhore hyn në fuqi më 02.07.2013.

**Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

**Valdete Daka**

